



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Gjuhë e folur (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; ... leksione / 40 seminare
Viti / Semestri : Viti I, Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor “Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studentët do të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për t'iu përgjigjur situatave dhe strukturave gjuhësore të drejtpërdrejta me gojë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët do të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar pikat kryesore, por edhe disa detaje thelbësore në një fjalim të zhvilluar që ka të bëjë me çështje të njohura në lidhje me punën, arsimin, argëtimin etj.
2. Studentët do të kenë aftësinë të kuptojnë, të përfshihen në biseda me folës natyrorë dhe të përgjigjen në fusha tematike si: njoftime ose informacione publike, reklama në programe televizive dhe radio, udhëzime nga punonjësit e shërbimeve të ndryshme, tregime dhe përshkrime të ngjarjeve, njerëzve, objekteve, hapësirave, ngjarje aktuale ose çështje të interesit personal/ profesional, arsimit, koha e lirë, udhëtimet, mallrat e konsumit, marrëdhëniet shoqërore etj

Rezultatet e pritshme:

1. Kuptojë pikat kryesore dhe detaje të rëndësishme në fjalime të qarta që trajtojnë tema të njohura si puna, arsimi dhe argëtimi.
2. Ndjekë dhe interpretojë informacione nga burime të ndryshme të dëgjuara (si njoftime publike, reklama, udhëzime, etj.) dhe të përvetësojë mesazhin bazë.
3. Ndërveprojë në mënyrë të kuptueshme në biseda të thjeshta me folës natyrorë, duke marrë pjesë aktive dhe duke u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme.
4. Përshkruajë përvoja personale, ngjarje, njerëz apo vende në mënyrë të qartë dhe të organizuar me gojë.
5. Shprehë mendime të thjeshta dhe të mbështetura për tema të njohura ose që lidhen me interesin personal dhe profesional.